



**REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES**  
**REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT**  
**REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSEDNICE**

---

Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës në pajtim me Rregulloren MF - Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve (21 qershor 2017) dhe Udhëzimit Administrativ (SZP) Nr. 04/2021 për Ndarjen e Subvencioneve në Presidencë (26 gusht 2021), hapë:

**THIRRJE PUBLIKE PËR OFRIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE/PROGRAMEVE PËR PERSONA FIZIK DHE OJQ**

Kjo thirrje publike bëhet më qëllim të mbështetjes financiare të projekteve apo programeve të propozuara nga:

- personat fizik dhe OJQ-të, e të cilat janë të fokusuar në fushat si në vijim:
  - mbrojtja e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut;
  - çështje gjinore dhe integrim socio-ekonomik;
  - rinia dhe inovacioni;
  - sporti, arti, kultura dhe arsimi;
  - mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i politikave të gjelbra;
  - çështje që konsiderohen me interes për komunitetin;
  - çështje që konsiderohen me interes për përfaqësim shtetëror;
  - veprimtari të tjera të cilat bien në kuadër të përgjegjësisë kushtetuese të Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës.

Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale, si në vijim:

- objektivat e projektit/programit të jenë të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe realisht të arritshme;
- aktivitetet e projektit/programit të jenë të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme;
- kostot e projektit/programit të jenë reale në lidhje me rezultatet specifike dhe kohëzgjatjen e pritshme të projektit.

Personat fizik dhe OJQ-të, mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje publike.

Të drejtë aplikimi me projektet/programet e tyre kanë personat fizik dhe OJQ-të, që dëshmojnë se projekti/programi i tyre është i fokusuar në njërin nga fushat e kësaj Thirrje Publike.

Personat fizik dhe OJQ-të obligohen që t'i kryejnë transaksionet financiare për realizimin e projektit për të cilin kanë përfituar mbështetjen financiare nga Zyra e Presidentes në mënyrë transparente

sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të përmbushin detyrimet kontraktuale të krijuara deri në përfundim të programit/projektit të paraqitura edhe në kontratë.

Kërkesat dhe propozimet do të dorëzohen vetëm në formularin e aplikimit, i cili është në dispozicion në ueb-faqen e Presidencës: <https://president-ksqov.net/sq/shpallje-195>

- Dokumentet duhet të dorëzohen fizikisht në **dy (2) kopje**.
- Dokumentet e kompletuara nuk do të pranohen përmes postës elektronike.
- Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht ose me postë, në adresën e mëposhtme:

*Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës  
Sheshi Nëna Terezë, Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Zyra e Arkivit, Nr. N 319,  
10000, Prishtinë, Republika e Kosovës*

Aplikimi i personave fizik dhe OJQ-ve, do të konsiderohet i plotë nëse e ka të plotësuar të gjithë dokumentacionin përkatës siç kërkohet në thirrje publike, si në vijim:

1. Formularin e plotësuar të aplikimit, ku përfshihet pjesa narrative dhe financiare e kërkesës;
2. Kopjen e dokumentit të regjistrimit në organin kompetent, për OJQ-të;
3. Kopjen e dokumentit të vlefshëm identifikues, në rast të aplikimit nga personi fizik;
4. Kopjen e dokumentit identifikues të personit të autorizuar që përfaqëson OJQ-në;
5. Certifikatën valide të numrit fiskal;
6. Vërtetimin e llogarisë bankare aktive.

**Shuma totale e alokuar për këtë thirrje publike është 120,000 EUR.**

Procesi i pranimit të aplikacioneve, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e subvencionit, koha dhe mënyra e paraqitjes së ankesave, si dhe monitorimi i realizimit të projekteve, do të bëhen sipas Rregullores MF - Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe Udhëzimit Administrativ (SZP) Nr. 04/2021 për Ndarjen e Subvencioneve në Presidencë.

Vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe që i përmbushin në tërësi kushtet e përcaktuara të thirrjes publike do të shqyrtohen për mbështetje financiare.

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune nga dita e publikimit dhe përfundon më **11 mars 2022**.

Për çdo paqartësi lidhur me thirrjen publike mund të jepen sqarime vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [subvencione.zprk@president-ksqov.net](mailto:subvencione.zprk@president-ksqov.net), deri më datën **25.02.2021**.

**VINI RE:** Të gjitha aktivitetet e parapara në projektet/programet e aprovuara të kësaj thirrjeje duhet të respektojnë masat mbrojtëse anti-COVID 19 të vendosura nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si dhe rekomandimet e IKSHPK-së.